

1. Në Nenin 6.1. në Kapitullin “Parimet Themelore”, shtohet paragrafi “f”, me përmbajtje si më poshtë vijon:

“f. Referendumi i brendshëm, si mekanizëm i përfaqësimit direkt të vullnetit të anëtarëve, lidhur me çështje të rëndësishme të organizimit të brendshëm, ndryshimeve statutore e programore dhe vendimmarrjeve të caktuara, strategjike të partisë.”

2. Në kapitullin VII me titull “Anëtarësimi”, shtohet Neni 7.3./1, me përmbajtje si më poshtë vijon:

“Kërkesa për anëtarësim mund t’i drejtohet edhe Organizatës së PL-së në një Qendër Votimi të ndryshme nga ajo ku kërkuesi ka vendbanimin e qëndrueshëm dhe ushtron të drejtën e zgjedhjes, në rastet kur kërkuesi banon përkohësisht aty dhe jep kontribut. Kjo kërkesë, shqyrtohet nga Kryesia e PL-së në Njësinë Administrative që përfshin Organizatën e QV-së ku drejtohet kërkesa dhe nëse plotëson kushtet e Nenit 7.1. dhe pranohet, anëtarësimi i njoftohet Organizatës së Qendrës së Votimit ku kërkuesi ka vendbanimin e qëndrueshëm dhe ushtron të drejtën e zgjedhjes.”

3. Në Nenin 7.8. ku përshkruhen të drejtat e anëtarëve të Partisë së Lirisë, shtohen dy paragrafë të rinj “g” dhe “h”, me përmbajtje si më poshtë vijon:

“g. të propozojë mbajtjen e referendumeve për çështjet e parashikuara në Nenin 19.2. të këtij Statuti. Referendumi në këtë rast, mbahet kur atë e kërkojnë pesë mijë anëtarë në nivel kombëtar;

h. të votojë për çështje që hidhen në referendum, sipas parashikimeve të Nenit 19.3.;”.

4. Neni 8.1., në Kapitullin “Masat Disiplinore” ndryshohet si më poshtë vijon:

“8.1. Çdo anëtar i PL-së, që shkel në mënyrë të përsëritur detyrimet e parashikuara në Nenin 7.7., i nënshtrohet në mënyrë të përshkallëzuar marrjes së masave disiplinore.”

5. Në Nenin 8.2., si masë disiplinore, shtohet pika “c”, me përmbajtje si më poshtë vijon:

“c. çregjistrimi.”

6. Neni 8.4., ku përcaktohen forumet që marrin masat disiplinore, ndryshohet si më poshtë vijon:

“8.4. Kërkesa për dhënien e masës disiplinore në rastin e anëtarit të PL-së dhe të Kryetarit të Organizatës së PL-së pranë Qendrës së Votimit, i drejtohet Kryesisë së PL-së së Njesisë Administrative. Kërkesa për dhënien e masës disiplinore për delegatët e Konventës Kombëtare, i drejtohet Komitetit Drejtues Kombëtar, ndërsa përsa i përket rastit të funksionarit të PL-së, të zgjedhur apo të emëruar nga forumet e PL-së, kërkesa i drejtohet forumit, i cili e ka zgjedhur.”

7. Neni 9.4., ku citohen strukturat e organizimit të brendshëm në nivel vendor, ndryshohet si më poshtë vijon:

“9.4. PL-ja në nivel vendor ka këtë organizim:

Organizata pranë Qendrës së Votimit – OQV

Kryesia e PL-së në Njësinë Administrative – KNJA

Komiteti Drejtues i PL-së në Bashki – KDB

Kryesia e PL-së në Bashki

Sekretari Politik i Qarkut”.

8. Në Nenin 9.5., ku citohen strukturat e organizimit të brendshëm në nivel qendror, hiqet “Departamenti i Organizimit”.

9. Në Kapitullin X, titullit “Kryesia e PL-së në Njësinë Administrative”, i shtohet togfjalëshi “(ish--komunat)” dhe Neni 10.10., ndryshohet si më poshtë vijon:

“Kryesia e PL-së në Njësinë Administrative (ish-komunat)

10.10. Kryesia e Njësisë Administrative përbëhet nga Kryetarët e PL-së në OQV.”

Nenet 10.11., 10.14. dhe 10.15., që I referohen Kryesisë së Partisë së Lirisë në Njësitë Administrative, ndryshojnë respektivisht si më poshtë:

10. Neni 10.11.:

“Kryetari i PL-së në Njësinë Administrative zgjidhet në mbledhjen e parë të Kryesisë së PL-së në Njësinë Administrative.”

11. Neni 10.14.:

“Kryesia e Njesisë Administrative gjatë ushtrimit të aktivitetit politik:

- a. Organizon dhe koordinon punën e Organizatave të PL-së pranë Qendrës së Votimit, në territorin administrativ të Njesisë Administrative;
- b. Administron regjistrin e anëtarësisë së PL-së në nivel njësie administrative;
- c. Mund të propozojë kandidaturat për deputetë, për organet e qeverisjes vendore apo për çdo organizatë tjetër, ku kërkohet përfaqësimi politik i PL-së në territorin administrativ të saj;
- d. Monitoron dhe administron procesin e mbledhjes së kuotizacioneve;
- e. Koordinon punën e PL-së në të gjitha fushat, politike, ekonomike, shoqërore duke bashkëpunuar jo vetëm me Organizatat e PL-së pranë QV-ve dhe anëtarët e PL-së, por edhe me organizatat partnere të shoqërisë civile, të çdo grupimi tjetër shoqëror, përkrahës të PL-së apo individë në përputhje me parimet dhe normat e Programit dhe të Statutit të PL-së;
- f. Miraton pranimet, këshillimet, pezullimet apo çregjistrimet nga PL-ja, sipas parashikimeve të Neneve 8.3. dhe 8.4.;
- g. Organizon dhe administron fushatat elektorale për zgjedhjet në parti, për në organet e qeverisjes vendore apo për deputetë në Kuvendin e Shqipërisë, në zonën zgjedhore përkatëse, në përputhje me kompetencat që i jepen nga Statuti dhe vendimet e forumeve të PL-së;
- h. Raporton në mënyrë periodike në Kryesinë e PL-së në Bashki, për aktivitetin e PL-së në territorin administrativ të zonës zgjedhore përkatëse.”

12. Neni 10.15.:

“10.15. PL në Njësinë Administrative drejtohet nga kryetari i PL-së në Njësinë Administrative, i cili zgjidhet nëpërmjet votimit të fshehtë nga anëtarët e Kryesisë së PL-së së Njesisë Administrative, për një periudhë katër vjeçare.”

13. Nenet 10.17., 10.18., 10.19. dhe 10.20., nën titullin “Konventa e PL-së në Bashki” shfuqizohen.

14. Neni 10.21., ku sanksionohen kompetencat dhe organizimi i Komitetit Drejtues në Bashki, ndryshohet si më poshtë vijon:

“10.21. KD i PL-së së Bashkisë realizon drejtimin politik dhe organizativ të PL-së në periudhën midis dy zgjedhjeve në parti:

- a. KD i PL-së së Bashkisë përbëhet nga Kryetarët e PL-së të njësive administrative, të zgjedhurit në organet e qeverisjes vendore, kryetarja e LGI-së së Bashkisë, kryetari i LRI-së së Bashkisë dhe Kryetarët e Organizatave të Qendrave të Votimit në territorin e asaj Bashkie;
- b. Përgjigjet për zbatimin e vendimeve të Konventës Kombëtare, të KDK-së, si dhe të Kryesisë së PL-së;
- c. Koordinon veprimtarinë e PL-së në të gjitha fushat: politike, ekonomike e shoqërore;
- d. Në mbledhjen e parë pas konstituimit, KDB zgjedh Kryesinë, nënkryetarët dhe sekretarët e PL-së së Bashkisë;
- e. Komiteti Drejtues, si rregull, duhet të mbledhet jo më pak se një herë në tre muaj. Ai thirret me kërkesë të Kryesisë së PL-së, me kërkesë të Kryesisë së PL-së në Bashki dhe nga një e treta e anëtarëve;
- f. KDB ka të drejtë të koptojë në periudhën ndërmjet dy zgjedhjeve të brendshme, deri në 25% të numrit të anëtarëve të tij;
- g. Voton me “po” ose “jo” në mënyrë të fshehtë për Kryetarin e PL-së në Bashki, kur gjatë afatit për paraqitjen e kandidaturave për Kryetar të PL-së në Bashki, paraqitet vetëm një kandidaturë.”

Nenet 10.22., 10.23. dhe 10.24., ku pwrcaktohet organizimi dhe kompetencat e Kryesisë së Partisë së Lirisë në Bashki, ndryshohen respektivisht si më poshtë:

15. Neni 10.22.:

“10.22. Kryesia e PL-së në Bashki përbëhet nga kryetarët e PL-së të Njësive Administrative, që janë anëtarë të saj pa votim dhe anëtarët që propozohen dhe zgjidhen me votim të fshehtë nga KDB. Numri i anëtarëve të Kryesisë së Bashkisë, miratohet nga Kryesia e PL-së.”

16. Neni 10.23.:

“10.23. Kryesia e PL-së në Bashki mbledhet të paktën një herë në muaj. Ajo thirret nga Kryetari i PL-së në Bashki ose nga një e treta e anëtarëve të Kryesisë së PL-së në Bashki.”

17. Në Nenin 10.24., shfuqizohet paragrafi “e”.

18. Neni 10.25., ku sanksionohet roli i Kryetarit të Partisë së Lirisë në Bashki, ndryshohet si më poshtë vijon:

“10.25. Kryetari i PL-së së Bashkisë si rregull zgjidhet nga anëtarësia e bashkisë, me votim të fshehtë, me më shumë se një kandidat, sipas parimit një anëtar-një votë, ose në mungesë të kandidaturave alternative, zgjidhet me votim të fshehtë nga KDB, për një periudhë katër vjeçare. Vendimin mbi mënyrën e votimit të Kryetarit të PL-së në Bashki, e merr Kryesia e PL-së në Bashki, pas miratimit të kandidaturës apo kandidaturave të paraqitura.”

19. Nenet 10.31., 10.32., 10.33. dhe 10.34., nën titullin “Kryesia e PL-së së Qarkut”, shfuqizohen.

20. Pas Nenit 10.30., shtohet titulli “Sekretari Politik i Qarkut” dhe nen i ri, me numër 10.31., me përmbajtje si më poshtë vijon:

“Sekretari Politik i Qarkut

10.31. Sekretari Politik i Qarkut caktohet me vendim nga Kryesia e PL-së.

Sekretari Politik i Qarkut koordinon dhe monitoron veprimtarinë e strukturave dhe forumeve vendore, si dhe të kandidatëve për organet e qeverisjes vendore apo për deputetë në Kuvendin e Shqipërisë, në periudhat zgjedhore.”

21. Në Nenin 11.7., ku përcaktohen kompetencat e Konventës Kombëtare, shtohet paragrafi “g”, me përmbajtje si më poshtë vijon:

“g. Voton me “po” ose “jo” në mënyrë të fshehtë Kryetarin e PL-së, kur gjatë afatit për paraqitjen e kandidaturave për zgjedhjen e Kryetarit të PL-së, paraqitet vetëm një kandidaturë.”

Nenet 11.12. dhe 11.14., nën kapitullin ku përcaktohet organizimi dhe funksionet e Komitetit Drejtues Kombëtar, ndryshojnë respektivisht si më poshtë:

22. Në Nenin 11.12., paragrafi “n”, ndryshohet si më poshtë vijon:

“n. Komiteti Drejtues Kombëtar ka të drejtë të kooptojë në periudhën ndërmjet dy Konventave, deri në 25% të anëtarëve të KDK-së;”

Si dhe shtohet paragrafi “u”, me përmbajtje si më poshtë vijon:

“u. propozon me shumicën e anëtarëve mbajtjen e referendumeve për çështjet e parashikuara në Nenin 19.2. të këtij Statuti dhe miraton me vendim procedurën për zhvillimin e referendumeve.”

23. Në Nenin 11.14., pas togfjalëshit “...me vendim të Kryesisë”, shtohet togfjalëshi “... ose nga Kryetari i PL-së.”

24. Në Nenin 11.20., ku sanksionohet “Kryesia e Partisë së Lirisë”, paragrafët “g”, “h” dhe “j” ndryshojnë përmbajtjen si më poshtë vijojnë respektivisht:

“g. miraton numrin e anëtarëve të KDB-ve;

h. miraton listën e kandidatëve për kryetarë të PL-së të bashkive, që do t’i nënshtrohen më pas procesit të votimit në strukturat përkatëse;

j. përcakton Sekretarin Politik të Qarkut;”

25. Nenet 11.21., 11.22. dhe 11.23., nën titullin “Kryesia Ekzekutive” shfuqizohen.

26. Në Nenin 11.25., nën kapitullin “Kryetari i PL-së”, shtohet paragrafi me përmbajtje si më poshtë vijon:

“11.25. ... Nëse pas përfundimit të afatit të aplikimeve për konkurrimin për Kryetar të PL-së, rezulton i regjistruar vetëm një kandidat, zgjedhja e Kryetarit të PL-se bëhet nga anëtarët e Konventës Kombëtare, me votim të fshehtë.”

27.

28.Shtohet kapitull i ri me numër XIX, me përmbajtje si më poshtë vijon:

“XIX. MBAJTJA E REFERENDUMEVE

19.1. Anëtarët e PL-së kanë të drejtë të propozojnë mbajtjen e referendumeve.

19.2. Çështjet që mund të shqyrtohen në referendum janë ato lidhur me normat e Statutit, Programit dhe organizimit të brendshëm të PL-së.

19.3. Referendumet në PL mund të thirren nga shumica e anëtarëve të KDK-së së PL-së ose nga pesë mijë anëtarë. Për votimin e referendumeve thirret në votim e gjithë anëtarësia në nivel kombëtar.

19.4. Çështja e hedhur në referendum konsiderohet e miratuar, kur atë e votojnë pro, jo më pak se tre të pestat e anëtarëve pjesëmarrës në votim.

19.5. Procedurat për zhvillimin e referendumeve përcaktohen me vendim të KDK-së së PL-së.”

29. Shtohet kapitull i ri me numër XX, me përmbajtje si më poshtë vijon:

“XX. DISPOZITË TRANZITORE

20.1. Në rastet kur një apo më shumë strukturave të organizimit qendror apo vendor të PL-së iu ka kaluar afati statutor i ushtrimit të kompetencave apo funksioneve të tyre, vendimet merren sipas rastit nga strukturat e tjera, të cilat vazhdojnë të gëzojnë legjitimitet sipas Statutit.”